

KONKURSI NDËRKOMBËTAR PËR DIZAJNIMIN

e Sheshit Qendror të
qytetit të Rahovecit


Raporti i projektit



SHESHI QENDROR I QYTETIT
Centralni Gradski Trg / Central City Square
RAHOVEC



UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE



SHESI QENDROR I QYTETIT
Centralni Gradski Trg / Central City Square

RAHOVEC

United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat)
Nxitja e ndryshimit urban në Rahovec përmes rivitalizimit të Sheshit
Qendror të qytetit
Ndërtesa e Qeverisë “Rilindja” Kati 10, 10000 Prishtinë, Kosovë
www.unhabitat.org
www.unhabitat-kosovo.org
www.centralsquare-rahovec.info

Fotografite, hartat dhe diagramet e përdorura në këtë raport janë pronë e UN-Habitat Kosova, nëse nuk është cituar ndryshe. Ato mund të riprodhohen me kushtin që burimi të shtypet me fotografite, hartat ose diagramet.

© UN-Habitat Kosovo.
Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2021
Kopertina © UN-Habitat

FALËNDERIMET

Autore kryesore: Blerina Boshnjaku
Recesioni: Zana Sokoli, Arion Xhemaj
Kontribues kryesorë: Zana Sokoli
Kontribues të tjerë: Reimonda Hoxha, Paul Boettcher

Falënderojmë **Komunën e Rahovecit** për bashkëpunimin e tyre përgjatë këtij procesi, në veçanti **Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**. Falënderime të shumta për drejtorin **z. Rumir Zhuniqi** dhe stafin e drejtorisë për punën e tyre. Falënderojmë anëtarët e **Ekipit Komunal për Planifikim (EKP)** për kontributin dhe sugjerimet e tyre. Së fundi, falënderojmë **qytetarët e Rahovecit** për pjesëmarrje në konsultime publike dhe për shprehjen e sugjerimeve/rekomandimeve të tyre për rivitalizimin e Sheshit Qendror të qytetit të Rahovecit.

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	i
Lista e figurave	i
Lista e tabelave	ii
1. HYRJE	03
2. SFONDI	07
3. STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE ANGAZHIMI PUBLIK FILLESTAR	13
3.1 Struktura institucionale	13
3.2 Lokacioni i konkursit dhe kufijtë	15
3.3 Dialogu me qytetarët/Konsultimi publik	19
3.4 Mbledhja e të dhënave në institucione dhe terren për përgatitjen e konkursit	24
4. PUNËT PËRGATITORE PËR ORGANIZIMIN DHE PËRGATITJEN E KONKURSIT	29
4.1 Programi i projektit dhe materiali i konkursit	29
4.2 Informimi dhe publikimi i konkursit	32
4.3 Çmimet	32
4.4 Plani i punës për konkursin	34
4.5 Përcaktimi i kushteve dhe kërkesave të programit/ Aplikimi dhe dorëzimi	34
5. KONKURSI	36
5.1 Konferenca dhe vizita në lokacionin e projektit	36
5.2 Pyetjet më të shpeshta	36
5.3 Pranimi i propozimeve në konkurs	36
5.4 Puna e jurisë: Vlerësimi analitik dhe vendimi detyrues i jurisë	39
5.4.1 Vizita në lokacion	39
5.4.2 Vlerësimi analitik	41
5.4.3 Vendimi detyrues i jurisë	43
5.5 Ekspozita dhe përzgjedhja e Çmimit të Komunitetit	43
5.6 Propozimet fituese	45
6. PUBLIKIMI	70
6.1 Shpallja e fituesve dhe publikimi i propozimeve	70
6.2 Kontaktimi i fituesve dhe ceremonia e çmimeve	70
6.3 Hapat e ardhshëm	70

LISTA E SHKURTESAVE

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
EKP	Ekipi Komunal për Planifikim
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1.** Teoria e ndryshimit Rahovec.
- Figura 2.** Skema e procesit.
- Figura 3.** Takimet e EKP-së.
- Figura 4.** Kufijtë e konkursit.
- Figura 5.** Kufiri i zonës 1.
- Figura 6.** Kufiri i zonës 2.
- Figura 7.** Kufiri i zonës 3.
- Figura 8.** Kufiri i zonës ngjitur.
- Figura 9.** Konsultimet publike, pjesëmarrja në bazë të moshës dhe gjinisë.
- Figura 10.** Hisedarët.
- Figura 11.** Konsultimet publike, pjesëmarrja në bazë të nivelit të arsimimit.
- Figura 12.** Vizioni i qytetarëve për Sheshin Qendror të qytetit.
- Figura 13.** Konsultimet publike, përgjigjet e qytetarëve në pyetësor.
- Figura 14.** Skema e procesit të mbledhjes së të dhënave.
- Figura 15.** Faqja zyrtare e konkursit.
- Figura 16.** Çmimet.
- Figura 17.** Shpallja e konkursit.
- Figura 18.** Kalendari i konkursit.
- Figura 19.** Vendet prej nga janë dërguar aplikimet.
- Figura 20.** Vizita në lokacion (02 Dhjetor 2020).
- Figura 21.** Vlerësimi i jurisë (03 Dhjetor 2020).
- Figura 22.** Ekspozita (14-18 Dhjetor 2020).
- Figura 23.** Çmimi i parë.
- Figura 24.** Çmimi i dytë.
- Figura 25.** Çmimi i tretë.
- Figura 26.** Çmimi i nderit.
- Figura 27.** Çmimi i nderit.
- Figura 28.** Çmimi i komunitetit.

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Përfituesit e projektit.

Tabela 2. Ekipi i angazhuar në konceptin e programit dhe projektin e programit.

Tabela 3. Ekipi i angazhuar në procesin e konkursit.

Tabela 4. Ekipi Komunal për Planifikim.

Tabela 5. Të dhënat e mbledhura në terren.

Tabela 6. Informatat dhe të dhënat e mbledhura nga drejtoritë komunale dhe institucionet publike.

Tabela 7. Sfidat dhe zgjidhjet në formimin e strukturave institucionale dhe angazhimin publik fillestar.


Tabela 8. Hartat dhe dokumentet të vëna në dispozicion të pjesëmarrësve.

Tabela 9. Sfidat dhe zgjidhjet në punët përgatitore për organizimin dhe përgatitjen e konkursit.

Tabela 10. Sfidat dhe zgjidhjet në organizimin e konkursit.

Tabela 11. Sfidat dhe zgjidhjet në publikimin e rezultateve.





HYRJE

Nxitja e ndryshimit urban në Rahovec përmes rivitalizimit të Sheshit Qendror të qytetit është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe zyrës së UN-Habitatit në Kosovë. Ai synon të promovojë rigjenerimin urban dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të hapësirës publike përmes metodave gjithëpërfshirëse, transparente dhe inovative të planifikimit dhe projektimit. Veçanërisht, projekti ka ofruar mbështetje teknike për procesin e Konkursit Ndërkombëtar të dizajnit të Sheshit Qendror të qytetit në komunën e Rahovecit. Projekti është financuar nga Komuna e Rahovecit.

Konkursi Ndërkombëtar për dizajnimin të Sheshit Qendror të qytetit të Rahovecit është organizuar nga Komuna e Rahovecit me mbështetjen teknike të UN-Habitatit.

Komuna e Rahovecit ndodhet në rajonin perëndimor të vendit, me një sipërfaqe prej 275.89 km² dhe popullsi prej 56, 208 banorësh sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2011.

Komuna e Rahovecit është njëra ndër të paktat komuna të Kosovës që nuk ka një rrjet të duhur të hapësirave publike dhe nuk ka as shesh qendror të qytetit. Qyteti është një vend i traditës dhe kulturës, aktiviteteve dhe ngjarjeve, por i mungon një hapësirë e përbashkët publike e cila do t'i bënte bashkë në një vend të gjithë qytetarët pa përjashtim.

Shtirja aktuale e hapësirave të hapura publike në komunë është 0.19m²/ qytetar dhe standardet ekzistuese lokale për hapësirat publike nuk përputhen me ato të dëshirueshme. Në vitin 2016, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, komuna kishte vënë synimin që të investonte dhe të arrinte qëllimin e zhvillimit afatgjatë të hapësirës publike prej 7-10m² për kokë banori.

Ideja për këtë projekt kapital të qytetit rrjedh nga qëllimet e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal të Rahovecit (2018-2026 +) në kuadër të Qëllimit 6: Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike, si dhe është paraqitur si një nga zgjidhjet zhvillimore në kuadër të analizës SWOT të shërbimeve mjedisore, sociale dhe publike.

UN-Habitati ka ndihmuar në mënyrë aktive institucionet e Kosovës në fushën e qeverisjes, planifikimit hapësinor dhe administratës komunale që nga viti 1999.

Duke u bazuar në njohuritë, mjetet dhe ekspertizën e saj, zyra e UN-Habitatit në Kosovë ofron me kërkesë të partnerëve, pako strategjike dhe gjithëpërfshirëse të mbështetjes për të ndërtuar ose plotësuar kapacitetet komunale të planifikimit dhe menaxhimit, dhe funksione të tjera. Në përputhje me këtë, UN-Habitati ka siguruar mbështetje teknike për procesin e Konkursit Ndërkombëtar të dizajnit të Sheshin Qendror të qytetit të Rahovecit.

Njohuritë, mjetet dhe përvojat e fituara nga ky proces do të ndahen brenda AKK-së për të avancuar më tej çështjet e rigjenerimit urban dhe ato të hapësirës publike gjithëpërfshirëse, dhe qasjet dhe mjetet transparente për planifikimin/projektimin urban dhe proceset lokale të vendimmarrjes.





SFONDI

Konkursi Ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të qytetit synon ta vendosë Rahovecin në hartë dhe të promovojë rigjenerimin urban dhe zhvillimin e hapësirës publike gjithëpërfshirëse, përmes një procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe inovativ. Ai nxiti një dialog përmbajtësor publik në faza të ndryshme të procesit përmes mjeteve dhe metodave inovative, duke shënjestruar audienca të ndryshme (jo)institucionale, duke përfshirë gratë dhe vajzat, të rinjtë, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta.

Qëllimi i projektit është gjetja e një zgjidhjeje planifikimi dhe projektimi për Sheshin Qendror të qytetit, për të siguruar kështu qasje në hapësira të gjelbra dhe publike të sigurta, të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse, në veçanti për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta, si dhe për të hapur mundësi të punës dhe biznesit.

Përmes planifikimit dhe projektimit urban të përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës dhe angazhimit publik, Komuna e Rahovecit synon krijimin e një identiteti të ri për qytetin - gjithmonë në harmoni me traditën dhe kulturën e saj - dhe në të njëjtën kohë aspirojnë në hapjen e rrugës për krijimin e një rrjeti të hapësirave publike dhe të gjelbra duke plotësuar boshllëqet urbane me përdorim të përzier, mundësi ekonomike dhe ndërveprim shoqëror.

Projekti gjithashtu kombinoi asistencën në vend pune, të përshtatur enkas, drejt 'të mësuarit duke bërë', shërbimet këshilluese, mësimin kolegjial dhe shkëmbimin e përvojave gjatë të gjitha fazave, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore të autoriteteve lokale dhe akterëve të tjerë.

Përfituesit kryesorë të drejtpërdrejtë të projektit përfshijnë:


Komuna e Rahovecit	Projekti ofroi udhëzime të vlefshme për udhëheqësinë lokale dhe departamentet komunale, duke u shërbyer si një bazë politikëbërëseve për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe projekteve për rigjenerimin urban dhe hapësirën publike që avancojnë zhvillimin gjithëpërfshirës dhe qeverisjen e mirë. Komuna është pajisur dhe fuqizuar për të hartuar dhe zbatuar procese pjesëmarrëse dhe transparente në lidhje me planifikimin hapësinor, si dhe për të forcuar angazhimin demokratik të qytetarëve në vendimmarrje dhe për të rafinuar përgjigjen e komunës ndaj kërkesave të qytetarëve.
Qytetarët e Rahovecit	Me theks në banorët e zonës urbane të komunës (15892 banorë (rreze 800 m) dhe specifikisht ata që jetojnë në rreze 400 m nga vendi i projektit), si dhe udhëtarët dhe vizitorët pas zbatimit të zgjidhjes të përzgjedhur të planifikimit dhe dizajnit pas procesit të konkursit.
Shoqëria civile dhe komuniteti afarist i Rahovecit	Përfituan nga mundësitë për t'u angazhuar drejtpërdrejt me vendimmarrësit komunalë dhe për të kontribuar në artikullimin e nevojave dhe aspiratave të tyre, si dhe për të ofruar inputet dhe vlerësimet e tyre për zgjidhjet e propozuara. Cilësia e përmirësuar e qëndrimit në hapësirën publike do të stimulojë klimën e përgjithshme ekonomike të qytetit, duke promovuar historinë e gjatë të qytetit dhe traditën e tij të pasur si një qendër e rajonit të verës të Kosovës.

Tabela 1. Përfituesit e projektit.

Projekti synoi gjithashtu të shtyjë përpara zbatimin e Agjendës 2030 duke realizuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). I gjithë ky proces dhe vetë konkursi përfshiu 6 (5, 10, 8, 11, 13, 16) nga 17 synimet, me një fokus të veçantë në OZHQ 11, konkretisht 11.7 lidhur me hapësirat publike.

Ilustrimi më poshtë (Figura 1) tregon se si projekti është ancoruar në teorinë e fuqishme të ndryshimit, duke u mbështetur në synimet e ndryshme zhvillimore, të tilla si: qytete dhe komunitete të qëndrueshme, veprim klimatik, paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme, punë e denjë dhe zhvillim ekonomik, zvogëlim i pabarazive dhe barazi gjinore.

Figura 1. Teoria e ndryshimit Rahovec.



Procesi filloi me iniciativën e drejtorit për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në komunën e Rahovecit për të bërë një kërkesë në AKK për mbështetje në organizimin e një konkursi për dizajnimin e Sheshit Qendror të qytetit të Rahovecit. Pas disa takimeve ndërmjet përfaqësuesve të UN-Habitatit dhe autoriteteve komunale, palët u pajtuan që UN-Habitati ta mbështesë teknikisht Komunën e Rahovecit në procesin e organizimit të Konkursit Ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të qytetit të Rahovecit.

Në maj të vitit 2019, zyra e UN-Habitatit të Kosovë dhe Komuna e Rahovecit nënshkruan memorandum mirëkuptimi.

Figura 2. Skema e procesit.



Programi dhe materialit të konkursit



Afati për aplikim në konkurs



Vlerësimi i jurisë



GUSHT 2020 SHTATOR 2020 NËNTOR 2020 DHJETOR 2020

...



Hapja e konkursit



Shpallja e fituesve



Ekspozita

STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE ANGAZHIMI PUBLIK FILLESTAR

3.1 Struktura institucionale

Për të fuqizuar kapacitetet institucionale dhe të burimeve njerëzore të autoriteteve lokale, Komuna e Rahovecit ka pritur ekipin e projektit të UN-Habitatit për të siguruar punën e përbashkët të përditshme.

Emri dhe mbiemri	Pozita
Gwendoline Mennetrier	Këshilltare Kryesore Teknike
Zana Sokoli	Këshilltare për Planifikim Hapësinor/Urban
Modest Gashi	Këshilltar për Planifikim Hapësinor/Urban
Artan Rexhepi	Zyrtar për Menaxhim të Programit
Arijeta Himaduna	Zyrtare për Barazi Gjinore/Ndërlidhje dhe Shoqëri Civile

Tabela 2. Ekipi i angazhuar në konceptin e programit dhe projektin e programit.

Emri dhe mbiemri	Pozita
Zana Sokoli	Udhëheqje/Mbikqyrje Këshilltare për Planifikim Hapësinor/Urban
Arion Xhemaj	Udhëheqës i projektit Zyrtar i programit/Planer Urban
Blerina Boshnjaku	Bashkëpunëtore për Zhvillim Urban
Reimonda Hoxha	Zyrtare për Komunikim
Leontina Cena	Asistente për mbledhje të të dhënave
Floriana Zllanoga	Asistente për mbledhje të të dhënave
Paul Boettcher	Praktikant
Artan Rexhepi	Zyrtar për Menaxhim të Programit

Tabela 3. Ekipi i angazhuar në procesin e konkursit.

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Partneritetet Publiko-Private dhe statutin e komunës së Rahovecit, më 29 mars 2020 u formua Ekipi Komunal për Planifikim (EKP) prej 12 anëtarësh. EKP përfshin zyrtarë dhe anëtarë të stafit të pothuajse secilit departament të komunës.

Emri dhe mbiemri	Departmenti	Roli
Rumir Zhuniqi	Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Udhëheqës
Shpejtim Mustafa	Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Kordinator
Sylejman Daka	Shërbime publike	Anëtar
Qemajl Krasniqi	Kulturë, Rini dhe Sport	Anëtar
Bjondina Ramaj	Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Anëtare
Selim Metkamberi	Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Anëtar
Bylbil Oruçi	Qendra për punë sociale	Anëtar
Esat Hoti	Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm	Anëtar
Muharrem Metbala	Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Anëtar
Saranda Shala	Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm	Anëtare
Ilvi Durguti	Agrikulturë, Pyllëtari dhe Zhvillim rural	Anëtar
Ardian Rama	Shëndetësi dhe përkujdesje sociale	Anëtar
Venhar Topalli	Shërbime publike	Anëtar

Tabela 4. Ekipi Komunal për Planifikim.

Janë mbajtur një numër takimesh, ku janë diskutuar tema të ndryshme:

- Prezantimi i procesit të organizimit të konkursit dhe i aktiviteteve të planifikuara;
- Kufijtë, skenarët e zhvillimit të lokacionit dhe dialogu publik;
- Shpallja e konkursit dhe afatet kohore.

3.2 Lokacioni i konkursit dhe kufijtë

Konkursi bën dallimin ndërmjet lokacionit aktual të projektit, një lokacioni më të gjerë strategjik dhe zonës më të gjerë urbane.

Kufijtë janë përcaktuar bashkërisht me Ekipin Komunal për Planifikim.

Lokacioni strategjik i konkursit përfshin një sipërfaqe prej 87.7 ha.

Një numër i madh i institucioneve dhe hapësirave publike, si dhe komponentë të tjerë strategjikë të qytetit janë përfshirë brenda kufirit strategjik. Kandidatëve iu është kërkuar të paraqesin një zgjidhje më të përgjithshme për lokacionin strategjik, duke shpjeguar lidhjen e lokacionit të projektit me hapësirat e tjera publike dhe objektet publike, si dhe zgjidhjet e mobilitetit dhe qasjes.

Lokacioni i projektit të konkursit ndodhet mu brenda qendrës së qytetit dhe mbulon një sipërfaqe prej 4.49 ha. Një pjesë e madhe e lokacionit ka qenë në pronësi të komunës, si një zonë strategjike për investime kapitale. Ajo është e rrethuar nga disa shërbime publike dhe tregtare si shkollat/kopshti, një muze/bibliotekë, një zyrë postare, bodrumi i verës dhe ndërtesat e trashëgimisë, si dhe tangjendon rrugët kryesore të qytetit (të cilat akomodojnë transportin publik ndër-urban të qytetit).



Figura 3. Takimet e EKP-së.



KUFIRI I ZONËS URBANE

KUFIRI STRATEGJIK

KUFIRI I LOKACIONIT

Figura 4. Kufijtë e konkursit.

Ekzistojnë një numër objektesh të rëndësishme publike brenda lokacionit të projektit të konkursit. Duke marrë parasysh funksionet e zonës, ajo mund të ndahet në tre zona kryesore:

Figura 5. Kufiri i zonës 1.

Objektet sportive - Stadiumi i futbollit “Jahja Danuza” dhe salla e mbyllur sportive “Mizair Isma”.



Figura 6. Kufiri i zonës 2.

Hapësirat e gjelbra publike dhe zona ujore (Parku i Qytetit dhe Lumi Duhlo).



Figura 7. Kufiri i zonës 3.

Lokalet afariste-tregtare (Hotel Park Plaza, tregu i hapur lokal dhe ish-ndërtesat e kooperativës bujqësore - ndërtesa ku tani ndodhet bar “Hardhia”).



Figura 8. Kufiri i zonës ngjitur.

Zona ngjitur me lokacionin e konkursit është një zonë me përdorim të kombinuar komercial-rezidencial, në pronësi private, me ndërtesa nga 1 deri në 4 kate.



3.3 Dialogu me qytetarët/ Konsultimi publik

Një aktivitet jetik i procesit të organizimit të konkursit ishte dialogu i filluar në faza të ndryshme të procesit. Ky dialog shënjestroi audiencën të ndryshme (jo)institucionale, duke përfshirë gra dhe vajza, të rinj, të moshuar dhe persona me nevoja të veçanta.

Për shkak të masave kufizuese të pandemisë COVID-19, takimet publike u anuluan dhe u desh të bëheshin riaranzhime. U dizajnuan një pyetësor digjital në një platformë të bazuar në hartë ku qytetarët kanë shprehur idetë, sugjerimet dhe vizionet e tyre për sheshin. Janë mbledhur një numër i konsiderueshëm përgjigjesh me kontribut nga mbi 1300 qytetarë (Figura 9).

Ka pasur një rritje të numrit të grave pjesëmarrëse në këtë proces, ku më shumë se 40% e pjesëmarrësve ishin gra, krahasuar me pjesëmarrjen e tyre të zakonshme në procese të tilla, veçanërisht në komunën e Rahovecit (20%).

Figura 9. Konsultimet publike, pjesëmarrja në bazë të moshës dhe gjinisë.







Figura 10. Hisedarët.

Gjatë këtij procesi janë mbledhur një numër i të dhënave cilësore dhe sasiore, në përpjekje për të kuptuar se ku shkojnë qytetarët për rekreacion; cilat rrugë janë më të frekuentuara për ecje ose vozitje; çfarë do të donin të ruanin dhe çfarë do të donin të largonin në lokacionin e projektit; çfarë aktivitete duhet të përmbajë sheshi; apo si e imagjinojnë sheshin pas 10 vjetësh?

Figura 11. Konsultimet publike, pjesëmarrja në bazë të nivelit të arsimit.



Bazuar në këto përgjigje, një vizion i përbashkët është përpiluar për Sheshin Qendror të qytetit:

“Sheshi qendror si një identitet i ri dhe pikë referimi për qytetin, i cili ofron qasje të sigurt në hapësira publike dhe të gjelbra për banorët e të gjitha moshave dhe gjinive, krijon mundësi të reja për zhvillimin e biznesit dhe promovon rigjenerimin urban të hapësirave të tjera publike, duke krijuar kështu një rrjet të organizuar dhe funksional në zonat urbane dhe rurale”.

Figura 12. Vizioni i qytetarëve për Sheshin Qendror të qytetit.

Cili është vizioni i juaj për Sheshin Qendror të qytetit?






Figura 13. Konsultimet publike, përgjigjet e qytetarëve në pyetësor.


3.4 Mbledhja e të dhënave në institucione dhe terren për përgatitjen e konkursit

Kandidatët kanë pasur në dispozicion informata dhe të dhëna në lidhje me lokacionin e projektit të konkursit, lokacionin më të gjerë strategjik, si dhe sipërfaqen e qytetit dhe të komunës. Këto informata dhe të dhëna janë mbledhur nga departamente të ndryshme të komunës dhe një numër institucionesh (Tabela 6).

Për më tepër, janë angazhuan dy asistente për mbledhjen e të dhënave në terren. Duke përdorur platforma inovative digjitale, ato kanë mbledhur të dhëna në lidhje me mjedisin e ndërtuar, peizazhin, aktivitetet, mobiliarin urban, qasshmërinë dhe rrjedhën e lëvizjes (Tabela 5).

Informatat dhe të dhënat e mbledhura në institucione dhe në terren janë përpunuar dhe prezantuar në përmbledhjen dhe programin e projektit dhe në materialet e konkursit.

Figura 14. Skema e procesit të mbledhjes së të dhënave.



Tema	Të dhënat e mbledhura
Mjedisi i ndërtuar	<ul style="list-style-type: none"> - Lokacioni; - Funksionaliteti; - Fasada; - Etazhiteti; - Përdorimi i ndërtesës; - Përdorimi i secilës etazhë; - Rrethoja; - Qasja; - Fotografi.
Peizazhi	<ul style="list-style-type: none"> - Lokacioni; - Tipologjia; - Kategoria; - Madhësia; - Fotografi.
Mobiliari urban	<ul style="list-style-type: none"> - Lokacioni; - Tipologjia; - Gjendja fizike; - Materiali; - Fotografi.
Aktivitetet	<ul style="list-style-type: none"> - Hapësira e shtrirjes së aktivitetit; - Tipologjia; - Numri i njerëzve; - Numri i grave, fëmijëve, të moshuarve, biçiklistëve, personave me nevoja të veçanta; - Numri i automjeteve të parkuara afër hapësirës së aktivitetit; - Karakteristikat (ndotja nga zhurmat, ndriçimi, hapësirat e hijezuara, mbeturinat); - Fotografi dhe video.
Qasshmëria	<ul style="list-style-type: none"> - Lokacioni; - Objekti për (jo)qasje; - Në qasjen e kujt ndikon objekti?; - Niveli i pamundësimin të qasjes që objekti krijon; - Numri i personave me nevoja të veçanta duke përdorur atë pikë të qasjes; - Fotografi.
Fluksi i lëvizjes	<ul style="list-style-type: none"> - Numri dhe drejtimi i lëvizjes së këmbësorëve, makinave, biçikletave, autobusëve dhe mjeteve për transport të mallrave.

Tabela 5. Të dhënat e mbledhura në terren.



Built environment

Specify primary building access point

North; East; South; West; North-east; North-west; South-east; South-west

South-east

and

1 2 3 4 5 6 7 8 9 0
q w e r t y u i o p
a s d f g h i k

Drejtoria/Institucioni	Dokumenti/Të dhënat
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Dokumentet e planifikimit strategjik: - Plani Zhvillimor Komunal 2011; - Plani Zhvillimor Komunal (2018-2026); - Plani i Mobilitetit Urban 2016-2021; - Plani për Investime në Hapësirat e Hapura Publike 2016-2021; - Drafti i Planit Rregullues për Qendrën e vjetër të qytetit.
	Vendimi për zhvendosjen e stadiumit të futbollit.
	Informata për mikroklimën dhe makroklimën, drejtimin e erërave dhe të dhëna të tjera relevante.
	Linjat e transportit publik dhe vendndalesat për autobus.
	Informata për drejtimin e vërshimeve në nivel të qytetit dhe të lokacionit.
	Planet e ndërtesave në lokacionin e projektit.
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	Matjet gjeodezike.
	Pronësia e tokës.
	Kopjet e planit dhe certifikatat e pronësisë.
Drejtoria për Arsim	Kontaktet e drejtorëve të shkollave.
Kompania e ujësjellësit rajonal K.R.U. Gjakova	Rrjeti nëntokësor për furnizim me ujë dhe largim të ujërave atmosferik dhe fekal.
Kompania Kosovare për Distribuim me Energji elektrike (KEDS)	Infrastruktura nëntokësore.
Stacioni Policor në Rahovec	Të dhëna për aktivitetet e planifikuara, udhëkryqet kritike, rrugët më të frekuentuara dhe numri i aksidenteve në qendër të qytetit.

Tabela 6. Informatat dhe të dhënat e mbledhura nga drejtoritë komunale dhe institucionet publike.

Sfidat

Mungesa e organogramit.

Zgjidhja Vendosja e EKP-së në bashkëpunim të ngushtë me stafin e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Takimet e EKP-së në kohë pandemie, organizimi i takimeve në internet, stafi nuk posedon pajisje digjitale në shtëpi, stafi i vjetër në moshë, etj.

Zgjidhja Numër i kufizuar i takimeve duke respektuar masat parandaluese të pandemisë si përdorimi i maskës, mbajtja e distancës dhe mirëmbajtja e higjienës personale.

Pronat private në lokacion të konkursit.

Zgjidhja Shpronësimi i tokës nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Masat kufizuese në mbajtjen e takimeve publike gjatë pandemisë COVID-19.

Zgjidhja Organizimi i pyetësorit në internet të bazuar në hartë.

Përfaqësimi gjinor në pyetësin në internet.

Zgjidhja Angazhimi i dy asistenteve për mbledhje të të dhënave për mbledhje të përgjigjeve në terren nga gratë.

Përfaqësimi i grup-moshave në pyetësin në internet.

Zgjidhja Organizimi i një pyetësi të veçantë për fëmijë nën 15 vjeç dhe ndarja e pyetësorit përmes Drejtorisë për Arsim.

Platforma e pyetësorit në internet e komplikuar për përdorim të përgjithshëm.

Zgjidhja Përgatitja e një video udhëzuese në përdorimin e pyetësorit.

Komunikimi me institucione publike me kapacitete të shkurtuara humane gjatë pandemisë.

Zgjidhja Paralelizimi i aktiviteteve gjatë kohës së pritjeve të përgjigjeve.

Mungesa e matjeve gjeodezike.

Zgjidhja Angazhimi i një kompanie private në përgatitjen e incizimeve gjeodezike të lokacionit të konkursit.

Mungesa e të dhënave të digjitalizuara dhe hartave të qytetit të Rahovecit.

Zgjidhja Digjitalizimi i hartave dhe të dhënave nga fotografi satelitore dhe burime të tjera.

Mungesa e të dhënave.

Zgjidhja Angazhimi i dy asistenteve në mbledhjen e të dhënave në terren.

Saktësia e të dhënave të mbledhura në kohë pandemie.

Zgjidhja Riorganizimi kohor i aktiviteteve dhe marrja në konsideratë e ndryshimit të mënyrës së jetesës gjatë pandemisë.

Rreziku i infektimit gjatë mbledhjes së të dhënave në kohë pandemie.

Zgjidhja Respektimi i masave parandaluese të pandemisë si përdorimi i maskës, mbajtja e distancës dhe mirëmbajtja e higjienës personale.

Tabela 7. Sfidat dhe zgjidhjet në formimin e stukturave institucionale dhe angazhimin publik fillestar.

PUNËT PËRGATITORE PËR ORGANIZIMIN DHE PËRGATITJEN E KONKURSIT

4.1 Programi i projektit dhe materiali i konkursit

Informatat dhe të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe integruar në programin e projektit dhe materialin e konkursit.

Përmbledhja e konkursit dhe programi i projektit përmbanin informata në lidhje me komunën e Rahovecit, si dhe rajonin, qëllimin e konkursit, informata për lokacionin e projektit dhe kërkesat/kushtet/rregulloret.

Në dosjen 'Materiali i konkursit', një numër hartash dhe fotografish kanë qenë në dispozicion për pjesëmarrësit (Tabela 8).

Programi i projektit, materiali i konkursit, deklarata e autorësisë dhe termat dhe kushtet mund të shkarkohen në <https://centralsquare-rahovec.info/documents/>.

Faqja zyrtare e konkursit (www.centralsquare-rahovec.info) është dizajnuar me qëllimin për të shërbyer për shpërndarjen e informatave dhe lajmeve në lidhje me konkursin, shkarkimin e materialit dhe aplikimin në konkurs.

Tema	Harta/dokumentet
Informata të përgjithshme	<ul style="list-style-type: none">- Kufijtë;- Lokacioni i projektit në raport me komunën;- Sheshi Qendror i qytetit të Rahovecit (.kmz);
Dokumentet e planifikimit strategjik	<ul style="list-style-type: none">- Plani lokal i menaxhimit të mbeturinave 2016-2021;- Plani Zhvillimor Komunal 2018-2026;- Plani për Investime në Hapësirat e Hapura Publike 2016-2021;- Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2016-2020;

Tema	Harta/dokumentet
Zona Urbane	<ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia kulturore në zonën e qytetit; - Trashëgimia kulturore sipas periudhës së ndërtimit; - Vërshimet; - Pronësia e tokës; - Okupimi i hapësirës; - Institucionet publike; - Kategorizimi i hapësirave publike; - Rrjeti i hapësirave publike; - Transporti publik; - Kategorizimi i rrugëve; - Lokacioni i projektit në kontekst të qytetit; - Topografia; - Vreshtat; - Zona urbane (.dwg);
Zona strategjike	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitetet; - Fluksi i biçikletave; - Qasjet në ndërtesa; - Gjendja e ndërtesave; - Lloji i aktivitetit afarist në përdhësë; - Funkzioni i përdhësës; - Shfrytëzimi i tokës; - Etazhiteti i ndërtesës; - Fluksi i këmbësorëve; - Llojet e aktiviteteve; - Fluksi i automjeteve;
Lokacioni i projektit	<ul style="list-style-type: none"> - Qasshmëria; - Shpërndarja e infrastrukturës elektrike; - Ndriçimi; - Mobiliari urban; - Vegjetacioni; - Infrastruktura e furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit; - Matjet gjeodezike (.zip); - Vegjetacioni; - Vegjetacioni (.dwg); - Fotografitë e vegjetacionit;
Fotografitë	<ul style="list-style-type: none"> - Fotografitë e lokacionit të projektit; -Këndet e fotografive.

Tabela 8. Hartat dhe dokumentet të vëna në dispozicion të pjesëmarrësve.



11 DAYS TO GO | 11 WEEKS TO GO | 14 MONTHS TO GO | 25 YEARS TO GO

Jury



ALEXIS SANAL
Chairperson



Prof. Dr. VANESSA MIRIAM CARLOW
International



FRÉDÉRIC SALIEZ
International



PËRPARIM RAMA
Advisor



DASHNOR KADIRI
Advisor



Prizes

1st Prize	2nd Prize	3rd Prize	2 Honorable mentions	Community Prize
7000€	3000€	2000€	Recognition/ Certificate	Recognition/ Certificate

Subscribe to newsletter

NAME AND SURNAME

EMAIL ADDRESS

Frequently Asked Questions

To access the Questions and Answers document click here

- Who is eligible to participate in the competition?
- How or where to register for the competition?
- How can I get the "team registration code"?
- Does the competition have a participation fee?
- What's the competition format?

Who is eligible to participate in the competition?

Urban planners, urban designers, architects and landscape architects or professionals of similar sectors, from all over the world, who are holding full occupational title may participate in the competition. The competition is also open to students or professionals of other fields, provided that the team leader is graduated in one of the above fields, all the before the closing day of the competition. The next three consist of up to four participants. The team is free to make collaborations, but there can only be up to four authors of the proposal.

(For example: A team composed of 4 members, one of which holds a master's degree in urban planning, urban design, architecture or landscape architecture. The three other members may be students of the mentioned fields or professional.) Students, to be eligible to participate you need the project leader's degree document. There is no need to have a design studio to be able to participate but all the same (i.e., design studios can participate in the competition)



Site location



VISIT US
Central City Square - Rahovec



EMAIL US
competition@centralsquare-rahovec.info

Figura 15. Faqja zyrtare e konkursit.

4.2 Informimi dhe publikimi i konkursit

Konkursi u shpall zyrtarisht përmes faqes zyrtare të tij dhe u shpërnda në mediat sociale.

Gjithashtu janë kontaktuar revista ndërkombëtare dhe vendore të njohura të arkitekturës dhe projektimit. Konkursi është ndarë përmes platformave digjitale në revista të ndryshme prestigjioze ndërkombëtare dhe vendore si: ArchDaily, Competition.archi, e-arkitekt, Bustler, etj. Janë kontaktuar universitetet prestigjioze të arkitekturës dhe asociacionet e arkitektëve dhe konkursi është ndarë brenda rrjeteve të tyre të komunikimit.

Faqja zyrtare e konkursit është vizituar më shumë se 49,000 herë nga më shumë se 16,000 vizitor të ndryshëm.

4.3 Çmimet

Vetëm projektet që kanë hyrë në listën e ngushtë kanë pranuar çmime.

Një fond prej gjithsej 12,000 EUR u është ndarë fituesve të vendit të parë, dytë dhe të tretë.

Për më tepër, dy vende nderi dhe çmimi i komunitetit janë shpërblyer me certifikatë/mirënjohje.

Figura 16. Çmimet.





CENTRAL CITY SQUARE
Sheshi Qendror i Qytetit / Centralni Gradski Trg

RAHOVEC



UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE



CALL FOR PARTICIPATION

www.centralsquare-rahovec.info

September 1 - November 16, 2020

Urban planners, urban designers, architects and landscape architects or professionals of similar sections are invited to participate in the International Design Competition for Central City Square of Rahovec (Kosovo). The International Design Competition for Central City Square of Rahovec is organized within the project Leading Urban Change in Rahovec through revitalization of the Central City Square. The aim of the project is to promote urban regeneration and the development of public spaces through inclusive, transparent and innovative methods of urban planning and design.

4.4 Plani i punës për konkursin

Konkursi u shpall më 1 shtator 2020, bashkë me faqen zyrtare të konkursit ku janë publikuar të gjitha informatat rreth konkursit.

4.5 Përcaktimi i kushteve dhe kërkesave të programit/ Aplikimi dhe dorëzimi

Konkursi Ndërkombëtar për dizajnimin e Sheshit Qendror të qytetit të Rahovecit ka qenë një konkurs idesh i hapur për planifikuesit urban, projektuesit urban, arkitektët dhe arkitektët e peizazhit ose profesionistët e lëmive të ngjashme. Pjesëmarrësit kanë mundur të marrin pjesë individualisht ose në ekip prej më së shumti katër anëtarësh ose si persona juridikë (studio e projektimit, ndërmarrje, etj.).

Regjistrimi dhe dorëzimi i propozimeve janë kryer së bashku përmes faqes zyrtare të konkursit, ku pjesëmarrësve iu është kërkuar të ngarkonin informatat e tyre, tre panele, një broshurë, një përshkrim të projektit, një foto të kopertinës dhe deklaratën e nënshkruar të autorësisë, si dhe termat dhe kushtet.

Sfidat	
Dizajnimi i uebfaqes së konkursit dhe aplikimit përmes uebfaqes.	
Zgjidhja	Angazhimi i një kompanie private për dizajnimin e uebfaqes së konkursit; parashikimi i ngarkesës së sistemit dhe testimi i sistemit.
Ngarkimi i sistemit para mbylljes së afatit për regjistrim dhe aplikim.	
Zgjidhja	Parashikimi i ngarkimit të sistemit dhe mirëmbajtja e uebfaqes dhe ofrimi i mbështetjes teknike gjatë mbylljes së afatit.
Ndarja e shpalljes së konkursit në tërë botën.	
Zgjidhja	Brendimi i konkursit, komunikimi me revista prestigjioze ndërkombëtare të arkitekturës dhe ndarja e shpalljes së konkursit në platformat e tyre.
Anonimiteti i punimeve.	
Zgjidhja	Secilës ekipë i është kërkuar të zgjedhin një kod alfa-numerik me gjashtë shifra sipas dëshirës. Kodi duhet të përmbante një shkronjë të madhe, një të vogël dhe një numër katër-shifror.

Tabela 9. Sfidat dhe zgjidhjet në punët përgatitore për organizimin dhe përgatitjen e konkursit.

Figura 17. Shpallja e konkursit.




Figura 18. Kalendar i konkursit.

5.1 Konferenca dhe vizita në lokacionin e projektit

Për shkak të masave kufizuese të udhëtimit si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, vizita në lokacionin e projektit dhe konferenca me rastin e hapjes së konkursit u anuluan.

Pjesëmarrësve u janë ofruar informata të hollësishme rreth lokacionit të projektit, duke përfshirë foto dhe video. Gjithashtu është publikuar xhiroja virtuale e lokacionit të projektit, ku pjesëmarrësit mund ta shihnin lokacionin nga një këndvështrim tjetër dhe të kuptonin pengesat e ecjes në lokacionin përkatës.

5.2 Pyetjet më të shpeshta

Duke filluar nga data 1 shtator 2020 e deri në afatin e përcaktuar, pjesëmarrësit e interesuar kishin mundësinë të dërgonin pyetjet e tyre në postën elektronike zyrtare të konkursit.

Dokumenti me përgjigje të pyetjeve më të shpeshta u publikua në faqen e konkursit në internet, së bashku me materialin shtesë.

